



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 155 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

VENDIM
Nr. 133, datë 31.05.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesë së **Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK)**, “Për miratim të venddepozitimit të përhershëm të gjetjeve arkeologjike pranë Universitetit të Tiranës”, ku aktualisht janë depozituar gjetjet për projektet e mëposhtme:
 - *Vendbanimi i Trenit;*
 - *Vendbanimi i Bishtit të Pallës;*
 - *Gjetje nga Projekti Arkeologjik Shkodër;*
 - *Gjetje nga terreni i Shkollës Eftali Koci (Durrës);*
 - *Gjetje nga projekti T.A.P.*
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA